



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:195733

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05825585

KPPP.nr. 1484/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit “AAG Project” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 71363635 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Prishtinës duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 273/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përbaruesi Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 14.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 273/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përbaruesi Privat Afet Mjeku.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 273/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përbaruesi Privat Afet Mjeku, MBETET NË FUQI.
- III. DETYROHET debitori Komuna e Prishtinës, që në emër të përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit “AAG Project” Sh.P.K., shumën prej EUR 208.00 (dyqind e tetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “AAG Project” Sh.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 03PR-04/2023, e datës 03.04.2023; Faturës nr. 02PR-04/2023, e datës 03.04.2023; Faturës nr. 01PR-02/2023, e datës 07.03.2023 dhe Faturës

nr. 04PR-04/2023, e datës 03.04.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 273/23, të datës 24.08.2023, me të cilin është urdhëruar debitori Komuna e Prishtinës, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 47,866.00, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në vlerë prej EUR 208.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartimor e të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim nuk janë të nënshkruara nga debitori dhe nuk janë të vulosura, ashtu që këto të meta në fatura paraqesin shkak që urdhri të anulohet. Më tej, ka theksuar se lidhur me shërbimet e kreditorit, i njëjti në fatura nuk ka bashkangjitur situacionin e punëve, andaj nuk dihet nëse çmimet përkojnë me faturat e lëshuara. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se përmbajtja e prapësimin nuk përmbush asnjë nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së, për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Ka shtuar se debitori nuk e ka kundërshtuar borxhin si dhe pretendimi se nuk ka pranuar faturat është i pa bazuar pasi që të njëjtat i ka pranuar, vulosur dhe përmbajnë datën dhe numrin e protokollit të debitorit. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej EUR 416.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, "*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*", ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: "*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe*

*debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *"Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit"*.

Gjykata vlerëson se përmbaruesi privat ka lejuar urdhrin përmbarimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 03PR-04/2023, e datës 03.04.2023; Faturës nr. 02PR-04/2023, e datës 03.04.2023; Faturës nr. 01PR-02/2023, e datës 07.03.2023 dhe Faturës nr. 04PR-04/2023, e datës 03.04.2023, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është emërtuar qartë objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjen se faturat mbi të cilat është iniciuar procedura përmbarimore janë lëshuar në mënyrë të rregull nga ana e kreditorit, ndërsa të njëjtat janë pranuar, nënshkruar dhe mbajnë vulën e protokollit të debitorit. Poashtu, kreditori së bashku me propozim për përmbarim, për secilën faturë objekt përmbarimi ka bashkëngjitur edhe rekomandimin e organit mbikëqyrës – menaxheri i kontratës në kuadër të debitorit për pagesë të faturave të lëshuara nga kreditori, së bashku me konstatimin mbi vlerën e punimeve që kanë qenë objekt i faturave. Andaj, nisur nga një gjendje e tillë, rezulton se debitori ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e faturës, lartësinë e detyrimit të përcaktuar në faturë dhe kryerjen e shërbimeve mbi bazën e së cilave janë lëshuar fatura, ndërsa të njëjtat nuk i ka kundërshtuar më parë.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë në kuptim të nenit 71 të LPP-së, për anulimin e urdhrin mbi lejimin e përmbarimit, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

Vendimin mbi shpenzimet sikurse në pikë III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e mbështeti në dispozitat nga neni 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia

njohur shpenzimet kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 208.00 konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1484/23, datë 14.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.